



FLUIDING MS

Plastifikues për beton dhe suva / ngadalësues i lidhjes
Përgjigjet në: EN 934-2: T10

FUSHA E APLIKIMIT

Përgatitje e përzierjeve “standarde” të betonit të dedikuara për realizimin e pozicioneve të ndryshme të objektet ndërtimore (konstruksione të themeleve dhe të tjera nëntokësore, dysheme industriale, AB shtylla, direkë dhe konstruksione mes kateve, konstruksione betoni të rrugëve, objekte hidroteknike, murre mbështetëse e të tjera).

Përgatitje e përzierjeve të betonit të cilat janë të dedikuara për transport dhe vendosen me pompë;

Betonimi i elementeve ndërtimore me prerje të dendura me armaturë;

Betonim në kushte të temperaturave të larta ambientale;

Betonimi i prerjeve masive të betonit, ku ka rrezik nga paraqitja e pasojave të padëshiruara të shkaktuara nga procese egzoterme në betonin;

Përgatitje e përzierjeve injektuese të çimentos;

Përgatitje e betoneve ekonomike me raport optimal midis komponentëve dhe performancave të betonit;

CILËSI

- Mundëson reduktim të ujit deri më 12%;
- E shtyn fillimin e lidhjes së betonit;
- Mundëson transport të vazhduar dhe vendosje të betonit (deri 60 minuta);
- E përmirëson shkallën e përpunimit të betonit pa shtimin plus të ujit;
- E lehtëson vendosjen dhe kultivimin e betonit në kushte të temperaturave të larta ambientale;
- E rrit kompaktësinë dhe mos-depërtueshmërinë të betonit ndaj ujit;
- I përmirëson karakteristikat fiziko-mekanike të betonit (karakteristika të rritura përfundimtare të fortësisë);

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

CILËSI	METODË	VLERË E DEKLARUAR
Dukje	Vizuale	Lëng i kaftë
Masë volumi (në 20°C)	ISO 758	(1.15±0.03) g/cm ³
Përmbajtje e kloridëve	EN 480-10	≤0,1%
Përmbajtje e alkaleve	EN 480-12	≤4 %
pH vlerë (në 20°C)	ISO 4316	6,5±1,0



DOZIMI DHE PERFORMANCA:

Dozimi optimal i FLUIDING MS lëviz prej 0,3 deri 1,5% në raport me sasinë e çimentos në përzierjen e betonit. Në rast të dozimit të tillë arrihet reduktim i ujit deri 12% (Diagram 1). Me këtë rast, në mënyrë përkatëse arrihet rritje e karakteristikave të fortësisë përfundimtare të betonit në 7 dhe 28 ditë (Diagram 2).




Diagram 1




Diagram 2

Beton referent I sipas EN 480-1 me përdorim të CEM I 42.5R

Dozimi optimal i FLUIDING MS më mirë përcaktohet me ekzaminime paraprake laboratorike ose industriale.

Në kushte të temperatura të larta ambientale ose në rast në rast kur prodhimi, transporti dhe vendosja e betonit zgjat më gjatë se 60 minuta, dozimi i rekomanduar të FLUIDING MS është mbi 1,0%, ndërsa betoni i freskët duhet të jetë i klasit më të lartë të konsistencës (S3 ose S4).

Dozimi i aditivëve bëhet në mënyrë manuale ose automatikisht gjatë prodhimit të betonit. Efekti më i mirë arrihet kur FLUIDING MS shtohet bashkë me 20-30% nga uji i nevojshëm, në agregatin, çimenton dhe 80% të ujit paraprakisht të përzier. Kohëzgjatja e rekomanduar e përzierjes së betonit të freskët me shtimin e FLUIDING MS nuk duhet të zgjasë më pak se 90 sekonda.

Efekte nga tej-dozimi: Dozimi tejet i lartë i FLUIDING MS mund të shkaktojë segregacion (ndarje) dhe lidhje të shtyrë të betonit.

KOMPATIBILITET

FLUIDING MS është kompatibel me të gjithë aditivët nga programi i ADING. Nëse në përzierjen e betonit përdoren dy ose më tepër aditivë nevojitet që të bëhen ekzaminime paraprake. Aditivët e ndryshëm dozohet veç e veç përkatësisht nuk përzihen mes vete para vënies në përzierjen e betonit. FLUIDING MS është i përdorshëm me të gjitha llojet e portland çimentos duke përfshirë edhe çimentot rezistuese ndaj sulfateve.

PAKETIMI

Kova plastike: 5 dhe 20 kg

Fuçi: 220 kg


Kontejnerë: 1100 kg



VENDOSJE NË DEPO

Në paketim original në temperaturë prej 5°C deri 35°C. Afati i përdorimi 12 muaj.

SHENJË PËR PRODHIM TË ÇERTIFIKUAR

 2032	
ADING AD Shkup Novoselski pat (rruga 1409) nr. 11, 1060 Shkup, Maqedoni 09 2032-CPR-08.40B EN 934-2:2009+A1:2012	
FLUIDING MS Aditiv për beton, plastifikues / ngadalësues EN 934-2:T10	
Përmbajtje maksimale e klor joneve:	0.1%
Përmbajtje maksimale e alkaleve:	4.0%
Veprim korroziv:	Përmban komponentë vetëm nga EN 934-1:2008, Aneks A.1

Rrezik për jetën: Fluiding MS nuk përmban materie toksike, por edhe krahas kësaj nevojitet që të kihet kujdes që materiali të mos vijë në kontakt me lëkurën, sytë ose të gëlltitet. Në rast të kontaktit me lëkurë ose me sytë, nevojitet që menjëherë të shpëlahem me ujë rrjedhës. Nëse gëlltitet, nevojitet që të kërkohet ndihmë mjekësore. Informacione shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.
Zjar: Fluiding MS është lëng që nuk mund të ndizet. Informacione shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.
Pastrimi dhe deponimi: Mbetjet e pa lidhura të Fluiding MS pastrohet me ujë. Ambalazhi i vjetër dhe i përdorur nevojitet të deponohen sipas dispozitave dhe rregullativave lokale për këtë lloj të mbeturinave. Informacione shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.